




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

MINISTRE SHTETI PËR
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Raporti VI
mbi trajtimin e ankesave dhe
sugjerimeve të sipërmarrjes
për muajin mars 2018





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA MINISTRE SHTETI PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Të nderuar miq sipërmarrës,

Në detyrën e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, në përmbushje të misionit të ndërmarrë për përmirësimin e klimës së biznesit në vend, lejomëni të ndaj me ju raportin e gjashtë të trajtimit të ankesave, në kuadër të njoftimeve periodike dhe raportimit mbi punën e kryer gjatë secilit muaj të kaluar.

Përmes këtij dokumenti, në emër të transparencës ju raportojmë kërkesat dhe sugjerimet e ardhura nga ju gjatë muajit mars si dhe zgjidhjen e ndërmarrë nga zyra jonë. Gjithsej kemi shqyrtuar 42 kërkesa, prej të cilave 33 kërkesë/ankesa, pas këshillimeve dhe gjetjes së hapësirave ligjore, janë trajtuar dhe zgjidhur. Gjithashtu gjatë muajit mars kemi zhvilluar dhe 7 tryeza të suksesshme sektoriale ndërmjet grupeve të interesit dhe institucioneve përkatëse, rezultatet e të cilave do të botohen në një raport të posatshëm në fund të muajit prill.

Gjatë muajit mars, kemi mbështetur ankesën e paraqitur nga ana e Shoqatës së Riciklimit të Mbetjeve, e cila denoncoi në emër të 31 kompanive që operojnë në territorin e Bashkisë Tiranë, shkelje procedurale gjatë kontrollit të ushtruar nga ana e Inspektoriatit përgjegjës, për të cilat u morën masa korrigjuese nga ana e këtij institucioni. Gjithashtu zyra jonë kontribuoi në procesin e rishikimit të Projektligjit për ushqimin (Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9863, datë 28.01.2008 "për ushqimin", i ndryshuar).

Duke besuar se marrëdhënia Qeveri-sipërmarrje ka hyrë tashmë në një fazë të re, atë të konkretësisë dhe bashkëpunimit të ndërsjellë, lutem konsiderojeni këtë dokument-raport si vullnet për komunikim intensiv, e sidomos si shteg përmes të cilit të drejtoni cdo shqetësim tuajin.

Mbetem me konsideratë,

Sonila Qato

Regjistri i ankesave të trajtuara

Nr.	Institucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr.1	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	01.03.2018	Subjekti raporton problematikë në lidhje me çregjistrimin e shoqërise nga ana e administratës tatimore në rastin kur shoqëria është çregjistruar në QKB.	Trajtuar me zgjidhje të problematikës.
Nr.2	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	02.03.2018	Kërkesë për miratimin e kalimit të të drejtave të licencë-marrvëshjes sipas Instrumentit të transferimit nënshkruar ndërmjet 2 shoqërive në fushën e përpunimit të naftës.	Trajtuar me miratimin e kalimit të licencë-marrvëshjes.
Nr.3	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	02.03.2018	Subjekti dërgon sugjerime mbi thellimin e luftës kundër informalitetit.	Trajtuar me përgjigje dhe marrë në konsideratë për zbatim nga administrate.
Nr.4	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	03.03.2018	Subjekti raporton mungesë informacioni mbi gjatësinë për punonjës të padeklaruar.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr. 5	DPD Dogana Berat	03.03.2018	Subjekti ankohet për aplikimin e referencave në çdoganimin e mallit.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.6	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	04.03.2018	Subjekti kërkon zbatimin e kreut 8 pika 4 të vkm nr.54,dt.05.02.2014 të ndryshuar, me qëllim privatizimin e pasurisë me emërtim X, së bashku me sipërfaqet funksionale të ndodhura në territor.	Trajtuar me përgjigje, në ndjekje të procedurave ligjore.
Nr.7	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	05.03.2018	Problematikë në lidhje me rimbursimin e TVSH-së.	Në ndjekje nga MFE mbi hartimin e një plani për rimbursimet e papambetura.
Nr.8	Ministria e Brendshme	06.03.2018	Problematikë lidhur me bllokimin e aktivitetit të Qendrës Private të Trajnimit të Punojseve të SHPSF.	Në ndjekje nga MB përmes miratimit të akteve rregulatore për këtë proces.
Nr.9	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	07.03.2018	Subjekti bën kërkesë për heqjen e detyrimeve për pagesat e principalit të kryera brenda afatit ligjor.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.10	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	09.03.2018	Subjekti kërkon rikontroll tatimor.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.11	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	09.03.2018	Subjekti raporton mos mbyllje në Q.K.R dhe një gjorbë që duhet të ishte hequr nga sistemi tatimor.	Trajtuar me zgjidhje.

Nr.	Institucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr.12	ZRPP Shkodër	10.03.2018	Subjekti raporton problematikë në regjistrimin e pronës.	Trajtuar me zgjidhje të problematikës.
Nr.13	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	11.03.2018	Subjekti raporton problematikë me OSHEE.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.14	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	11.03.2018	Ankesë mbi kohën e pritjes së tejzgjatur në pikat doganore.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.15	Ministria e Brendshme	13.03.2018	Subjekti bën kërkesë për lëshimin e certifikatave elektronike në kuadër të aktivitetit kredi-dhënës të institucioneve financiare.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.16	Ministria e Mjedisit dhe Turizmit	13.03.2018	Subjekti ankohet për pezullim të lejes mjedisore.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.17	Bashkia Ura Vajguore	14.03.2018	Subjekti raporton refuzim kërkesë për leje ndërtimore të paargumentuar.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.18	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	15.03.2018	Subjekti raporton trajtimin e padrejte nga AKU.	Trajtuar me përgjigje.
Nr. 19	DPD- Dega Qafë Thanë	16.03.2018	Subjekti ankohet për tejzgjatje të procedurave të zhdoganimit.	Trajtuar me zgjidhje
Nr.20	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	16.03.2018	Kërkesë për anulim aktvlerësimi.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.21	Ministria e Financave dhe Ekonomisë!	17.03.2018	Subjekti raporton problematikë me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Tiranë.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.22	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	19.03.2018	Subjekti kërkon rikontroll tatimor.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.23	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	19.03.2018	Subjekti raporton problem me OSHEE sa i takon shpërbërjeve të energjisë elektrike.	Trajtuar me zgjidhje.

Nr.	Institucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr.24	ZRPP Pogradec	22.03.2018	Subjekti raporton problematikë në regjistrimin e pronës.	Trajtuar me zgjidhje të problematikës.
Nr.25	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	23.03.2018	Subjekti raporton gjobitje te padrejtë dhe kërkon rikontroll tatimor.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.26	OSHEE	23.03.2018	Subjekti ankohet për mbifaturim të energjisë elektrike.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.27	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	24.03.2018	Ankesë mbi kohën e pritjes së tejzgjatur në pikat doganore.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.28	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	25.03.2018	Subjekti raporton vendosje gjobe për pasaktësi në prerjen e kuponit tatimor.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.29	ZQRPP	27.03.2018	Subjekti ka marrë lejen e përdorimit të objektit në Bashki ndërkohë që nuk është regjistruar në ZRPP.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.30	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	28.03.2018	Subjekti raporton mos-rinovim autorizimi për pajisje fiskale pa shpjegim.	Trajtuar me verifikim dhe lëshim të autorizimit.
Nr.31	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	30.03.2018	Subjekti kërkon sjelljen e energjisë elektrike në biznes.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.32	Ministria e Drejtësisë!	31.03.2018	Subjekti kërkon zbatimin e vendimit të gjykatës për zhbllokimin e sekuestrimit të mallit.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.33	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	31.03.2018	Subjekti raporton gjobitje te padrejtë dhe kërkon rikontroll tatimor.	Trajtuar me përgjigje.

